

Titulli i lëndës: TEKSTE SHQIPE ME ALFABET ARAB

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Tekste shqipe me alfabet arab
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i IV-të Semestri i VII-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa S100 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof Dr. Abdullah Hamiti
Të dhënat kontaktuese:	abdullah.hamiti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda “Tekste shqipe me alfabet arab” përfshin tekstet e ndryshme shqipe të krijuara me aphabet arab nga fundi i shekullit 17 deri në fillim të shekullit 20. Përqëndrimi bëhet kryesisht në tekstet letrare shqipe të shkruara me alfabet arab duke u njoftuar mirë për rrjedhat e zhvillimin e kësaj pjese të letërsisë shqipe, respektivisht për risitë letrare që këta krijues me alfabet arab i sollën letërsisë së vjetër shqipe. Njëherit studenti do të duhej të ketë njohuri të mjaftueshme edhe për përfaqësuesit më eminent të letërsisë alhamiada shqiptare që përfshihen në këtë cikël e të cilët konsiderohen pararendësit e letërsisë së Rilindjes kombëtare shqiptare dhe të jenë në gjendje që pa vështirësi të veçanta t’i lexojnë tekstet shqipe me alfabet arab.</p>

Qëllimet e lëndës:

Qëllimet kryesore i nënshtrohen shqyrtimit të qasjeve të ndryshme për studimin e teksteve shqipe me alfabet arab. Theksi do të vihet në zhvillimin e aftësisë së studentit për të deshifruar, transkriptuar dhe kuptuar se si të lexohen tekstet shqipe me alfabet arab. Këto mundësojnë njohjen e studentit për ta kuptuar më lehtë risitë letrare që këta krijues me alfabet arab i sollën letërsisë së vjetër shqipe; të ngriten debate dhe diskutime që do të nxisnin mendimin kritik të studentët për vlerat e letërsisë shqipe me alfabet arab; t'i kuptojnë shkaqet dhe impaktet e letërsisë shqipe me alfabet arab në zhvillimin e letërsisë shqipe në përgjithësi.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të:

- t'i krahasojë tekstet e ndryshme shqipe me alfabet arab dhe t'i përshkruaj dallimet e tyre grafike.

- t'ë diskutojë për ndryshimin stilistik, tematik dhe përmbajtësor të këtyre teksteve.

- të diskutojë problemet në leximin/transkriptimin e teksteve shqipe me alfabet arab të cilat sikundër dihet janë në dorëshkrim.

- të prezantojë rezultatet e letërsisë shqipe me alfabet arab duke identifikuar përfaqësuesit e saj më eminent.

- të diskutoj për metodën dhe problemet e transkriptimit të teksteve shqipe me alfabet arab.

- Të dallojë llojet e shkrimeve (paleografia)

- Të rajtojë llojet poetike të kultivuara në alhamiaddon shqiptare.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	1	15	15
Punë praktike			

Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin			4
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	10	1	10
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	1	15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			123
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorur material/tekste të ndryshme që do të zgjedhen nga autorët si: Mulla Dervish Peja, Nezim Frakulla, Muhamed Kyçyk Çami, Tahir Boshnjaku, Sheh Junuzi, H. Ali Ulqinaku, Sheh Mala etj. dhe do të diskutohen problemet e vështirësitë e leximit/transkriptimit të këtyre teksteve.		
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive 20%; Kollokfiumi 30%; Provimi final 50%.		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Abdullah Hamiti, <i>Vështirësitë e leximit të teksteve shqipe me grafi arabe</i>, "Seminar Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", 19, Prishtinë, 2001, f. 143-157. 2. Abdullah Hamiti: Nezim Frakulla dhe Divan i tij shqip, Logos – A, 2008, f. 481. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mahmud Hysa, Alamiada shqiptare, "Logos-A", Shkup, 1997; 2. Poezia e bejtexhinjve, (Përgatiti Hajdar Salihu), "Rilindja", Prishtinë, 1987; 3. Hasan Zyko Kamberi, <i>Poezi</i> (Botim tekstual kritik), Genciana Abazi-Egro, Tiranë, 2016. 4. Poezi shqipe me alfabet arab, përgatitën për botim: Abdulla HAMITI & Abdulla REXHEPI, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022 5. Shejh Maliqi dhe Divani i tij shqip, përgatiti: Jahja Hondozi, Logos-A, Shkup, 2014. 		

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Rrrethanat politike dhe kulturore para lidnjes së letërsisë shqipe me alfabet arab. Fillet e letërsisë shqipe me alfabet arab.
Java 2:	Karakteristikat e letërsisë shqipe me alfabet arab: simbolika, figuracioni. Format letrare të letërsisë shqipe me alfabet arab: Mersnevia, Kasidja, Gazeli, Ilahia...
Java 3:	Adaptimet e alfabetit arab për nevojat tingullore të gjuhës shqipe.
Java 4:	Karakteristikat e përbashkëta grafike të autërve të shkrimeve shqipe me alfabet arab -Vështirësitë e leximit të shkrimeve shqipe me alfabet arab.
Java 5:	Mulla Dervish Peja: Pjesë të zgjedhura nga vepra “Vasijetname” – lexim.
Java 6:	Nezim Frakulla : Poezi të zgjedhura nga divani shqip i Nezim Frakullës – lexim.
Java 7:	Muhamed Kyçyk Çami : Pjesë të zgjedhura nga vepra e Çamit – lexim.
Java 8:	Hasan Zyko Kamberi: Poezitë të zgjedhura – lexim.
Java 9:	Tahir Efendi Boshnjaku: Pjesë të zgjedhura nga vepra “Vehbije” – lexim.
Java 10:	Sheh Junuzi: Poezi të zgjedhura nga Divani – lexim
Java 11:	Hafiz Ali Ulqinaku dhe veprat e tij. Pjesë të zgjedhura nga veprat në dorëshkrim të Hafiz Ali Ulqinakut –lexim.
Java 12:	Fjalori në vargje turqisht-shqip i H. Ali Ulqinakut – pjesë nga fjalori.
Java 13:	Sheh Mala: Pjesë nga Divani i Sheh Malës – lexim.
Java 14:	Mevludet në gjuhën shqipe: Pjesë të zgjedhura nga tre mevludet në gjuhën shqipe. Mevludi i Konispolit, Hafiz Ali Ulqinakut dhe ai i Tahir Popovës.
Java 15:	Vlerësimi dhe diskutimi lidhur me detyrat në klasë dhe në shtëpi gjatë semestrit dhe përgatitja për provimin final.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Mjetet që përdoren gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Vijimi në ligjëratë dhe ushtrime duhet të jetë i rregullt, gjatë mbajtjes së mësimit duhet të mbretërojë qetësia, të shkyçen telefonat celular si dhe hyrja në sallë duhet të jetë me kohë. Plagjjarizmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr note negative.